

VENDIM
Nr. 718, datë 16.9.2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 328, DATË 22.4.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT, TË KATIT PËRDHES, NË OBJEKTIN NR. 1, TRE KAT, PJESË TË PRONËS NR. 1047, ME EMËRTIM ‘REPARTI USHTARAK NR. 6620 (PU)’, ME VENDNDODHJE NË LAGJEN ‘30-VJETORI’, BERAT, DHE SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 114, DATË 17.2.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TË DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, PËR DEGËN E ARKIVIT SHTETËROR VENDOR NË BERAT, TË KATIT TË PARË E TË KATIT TË DYTË TË OBJEKTIT NR. 1, DHE OBJEKTIT NR. 2, PJESË TË PRONËS NR. 1047, ME EMËRTIM ‘QENDËR MOBILIZIMI’, ME VENDNDODHJE NË BERAT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 328, datë 22.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 20-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes të Shërbimi Informativ i Shtetit, të katit përdhes, me sipërfaqe 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) m², në objektin nr. 1, tre kat, pjesë të pronës nr. 1047, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 6620 (PU)”, me vendndodhje në lagjen “30-Vjetori”, Berat, sipas planrilevimit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, si dhe të sipërfaqes truall (oborr) prej 312 (treqind e dymbëdhjetë) m², pjesë e pronës nr. 1047, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për vendosjen dhe zhvillimin e aktivitetit të administratës së Drejtorisë Vendore të Shërbimit Informativ të Shtetit, në Berat.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Ministria e Mbrojtjes, e përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake dhe Shërbimi Informativ i Shtetit të lidhin aktmarrëveshje ndërmjet palëve për dhënie në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të katit përdhes, me sipërfaqe 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) m², në objektin nr. 1, tre kat, pjesë të pronës nr. 1047, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 6620 (PU)”, sipas planimetrisë, si dhe të sipërfaqes truall (oborr) prej 312 (treqind e dymbëdhjetë) m², pjesë e pronës nr. 1047, sipas planrilevimit, me vendndodhje në lagjen “30-Vjetori”, Berat, duke përcaktuar kushtet dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet palëve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PLAN RILEVIMI

Prona nr.1047, "Rep. Usht. nr.6620, (PU) "

MIRATO HETI
Komandanti i Repartit Ushtarak nr.6620
Kolonel Altin KURTI

DREJTORI I IGJIU
Ark. Enca SINOIMERI

IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale 8502.
Nr.Pasurise 14/37 Vol. Fq
Indeksi i Hartes
BR;K-6,7, BR;L-6,7
Shkalla 1: 500
Adresa e pasurise Berat
Lagjia "30 Vjetori", Rruga "Koli VESHO", Berat.
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes, Policia Ushtarake.

PUNOI
Topograf Nikoll TUSHI

Korrik 2020

SISTEMI I KOORDINATAVE (KRGJSH)

SHPJEGUESE:

Sip.Përgjithshme= 1400.4 m²

Sip. nën objekte = 386.8 m²

Kufiri Repartit

Sip. e objektit të dhënë në përdorim SHISH me VKM nr.328, datë 20.04.2020 =198 m²

Sip. e truallit për t'u dhënë në përdorim SHISH =312 m²

